



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.19 Regj.Them.
Dt. Regj. 12.05.2023

Nr. 19 Vendimi
Dt. Vendimi 15.05.2023

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Marsela DERVISHI** (*Relarore*)
Gjyqtare: **Edlira PETRI** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)
Gjyqtare: **Emona MUÇI** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë 15.05.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. 19 Akti, datë 12.05.2023 që i përket:

PADITËS:

Bashkia Shijak, përfaqësuar nga z.Elton Arbana ID. 141225007R me cilësinë e kryetarit të saj, me adresë Shijak, Lagjja ‘Erzen’, përfaqësuar në gjykim nga znj. Teuta Plaku pajisur me Autorizim nr. 2492 prot., datë 12.05.2023.

I PADITUR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga znj. Ina Osmanaj, pajisur me Autorizim nr. 5130 prot., datë 14.05.2023.

OBJEKTI:

-Shfuqizimin e vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ - së .
-Revokimin e dënimit me gjobë për kryetarin e bashkisë z. Elton Arbana, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjet nr. 74,

datë 19.07.2012, nr. 31, datë 02.04.2015, nr. 101, datë 23.7.2020, nr. 118, datë 5.10.2020; shfuqizuar një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.6.2021, shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 4.10.2021) neni 145 e vijues, neni 172 të tij; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 108, neni 113, neni 114, KREU II “Ankimimi administrativ”, neni 130 e në vijim, neni 156 “Njoftimi me mjete elektronike”; ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 i ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr. 10 052, datë 29.12.2008, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 169 i K.Pr.Civile, i ndryshuar me ligjin nr. 122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; i ndryshuar me ligjin nr. 160/2013 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

Pasi u njoh me përmbajtjen e kërkesëpadisë, verifikoi legjitimitimin e palëve dhe dëgjoi palët në fazën e kërkesave paraprake, ku:

Pala paditëse, përfaqësuesi i Bashkisë Shijak deklaroi:

- Është paraqitur në cilësinë e përfaqësueses së Bashkisë Shijak si palë paditëse dhe jo si përfaqësuese e subjektit zgjedhor kandidatit për Kryetar të Bashkisë Shijak, z. Elton Arbana;

Pala e paditur, përfaqësuesja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deklaroi:

- Pala paditëse nuk ka legjitimitet për të paraqitur padinë, pasi nëpërmjet vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve", të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, nuk është vendosur sanksion administrativ ndaj Bashkisë Shijak, por ndaj subjektit zgjedhor, kandidatit për kryetar bashkie, z. Elton Arbana.

VËREN:

1. Se pala paditëse, Bashkia Shijak i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, me padinë me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr 84, datë 08.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe

Sanksioneve pranë KQZ -së Revokimin e dënimit me gjobë për kryetarin e bashkisë z. Elton Arbana, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.”.

2. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E CËSHTJES:

3. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Kryetari aktual i Bashkisë Shijak, z. Elton Arbana është subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, duke rikandiduar për kryetar të Bashkisë Shijak.

4. Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (në vijim KRIIK) ka paraqitur para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve denoncimin/raportin për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, nga 20 (njëzet) bashki dhe 1 (një) një kryetar bashkie, për të cilat pretendohet se kanë bërë postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive respektive, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike (Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023, “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023”). Në vijim pretendohet se: *Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 Janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#) e konkretisht për rastin në fjalë: (nr. 20) ...Në faqen zyrtare të Bashkisë Shijak është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë;#SkaKohëPërPushim.*

5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 441, datë 05.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 349, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj kryetarit të bashkisë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyre, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Poliçan, Prrenjas, Pustec, Roskovec, **Shijak** dhe Vorë për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ka vendosur:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për:

...

- Z. Elton Arbana, kryetar për bashkinë Shijak.

...

4. Urdhëroj fshirjen e menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të secilës Bashki, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.

5. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

6. Në këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndër të tjera ka arsyetuar: “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, nga 20 (njëzet) bashki dhe 1 (një) një kryetar bashkie, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive, përbëjnë përdorim të burimeve publike.

...Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj se faqet e rrjetit social “Facebook”, me emrin bashkive objekt denoncimi, janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve.

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1, parashikon se “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Po ky nen parashikon se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjete tjetër elektornik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Në kushtet ku nga bashkitë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, , Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak, objekt denoncimi, janë bërë një sërë publikimesh të cilat përmbajnë hashtag # dhe slogane me karakter politik/elektoral, duke keqpërdorur, këto llogari institucionale që përbëjnë burim publik, vlerësohet se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023.

...Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rastet objekt denoncimi të regjistruar me nr. 349 ID, për pikat nga 1- 15 dhe 17-20 përbëjnë shkelje të nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe duhet të fshihen menjëherë nga faqja e tyre e rrjetit social.

Për rrjedhojë, referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë”.

7. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me vendimin nr. 84 datë 08.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve” ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, bazuar në nenin 172, pikën 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, në cilësinë e subjektit zgjedhor ndaj:

- z. Elton Arbana, kryetar në bashkinë Shijak.

....

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

8. Në këtë vendim, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:

“... 2. Faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale (facebook, tëiter, instagram etj.) bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pra ato janë “burime” të institucionit në kuptim të kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqet zyrtare të bashkive në rrjetet e ndryshme sociale të sipërcituara, nuk mund të përdoren ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

3. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Ky ndalim është konfirmuar edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, i cili në përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara” ndalonon “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për qëllime zgjedhore”.

4. Ndërkohë, pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, në të cilën Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve është bazuar në propozimin e masës administrative ndaj personave përgjegjës, përcakton sanksionin për shkeljet e kryera “nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi”. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucionesh të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonant e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. Titullari i institucionit apo entit që ka në administrim asetin publik nuk bën pjesë në listën e “personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit”. Për këtë arsye, KAS çmon se ankioni për të nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

5. Për keqpërdorimin e burimeve publike Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi edhe subjektet zgjedhore përfutuese. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se “subjekte

zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetshëm, si dhe për shkak se postimet e aksesueshme në facebook bëjnë fjalë për veprimtari elektorale të tyre dhe jo të subjektit që e mbështet, atëherë për këto shkelje duhen trajtuar subjekt zgjedhor përfitues, kandidatët dhe jo partia politike që i mbështet ato.

6. Kandidatët për kryetar bashkie objekt i këtij procedimi administrativ, kanë qenë në dijeni të publikimit të shloganeve politico-elektorale në faqet zyrtare të rrjeteve sociale të bashkive të tyre. Publikimet në fjalë kanë qartësisht si qëllim sensibilizimin politik të publikut. Në kushtet kur ata gëzojnë cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidatë për kryetar bashkie, është e qartë se publikimet në shkelje të ndalimeve në Kodin Zgjedhor, janë kryer në favor të tyre. Në këto rrethana ata kanë pasur detyrimin për ndërprerjen e menjëhershme të shkeljes, gjë që nuk ka ndodhur.

7. Përgjegjësia për vendosjen në përdorim apo në mbështetje të kandidatëve apo të subjekteve zgjedhore të faqeve zyrtare të institucioneve publike është e kryetarit të bashkisë. Këtë e saktëson vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, nëpërmjet shkronjave “a” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 7. Gjithësesi, KAS-i konstaton se KQZ-ja nuk ka sensibilizuar në kohë publikisht, sikurse nuk ka paralajmëruar institucionet për largimin nga praktika e vjetër e përdorimit politik të faqeve të institucioneve në rrjetet sociale.

8. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se “subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Kjo do të thotë se hetimi administrativ për keqpërdorimin e burimeve publike duhet të shoqërohet në çdo rast edhe me hetimin për rolin e subjektit zgjedhor përfitues nga veprimtaria. Në përfundim të hetimit administrativ si Komisioneri, ashtu dhe KAS-i duhet të mbajnë qëndrim dhe vlerësim të shprehur për këtë rol.

9. Kandidatët për kryetar bashkie të ngarkuar me përgjegjësi sipas vendimit nr. 441, datë 05.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, gëzojnë statutë dyfishtë, si kandidatë dhe si kryetarë në detyrë të bashkive përkatëse. Si kryetar të bashkive, personat në fjalë kanë akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqen zyrtare të bashkive që ato drejtojnë. Ato kanë të gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljes së ligjit dhe për të marrë masa që kjo sjellje të mos përsëritet. Fakti që ata nuk e kanë ushtruar këtë pushtet deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri do të thotë se ata duhet t’i nënshtrohen, në cilësinë e subjektit zgjedhor, veprimit të sanksionit të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

10. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS-i çmon se kryetarët e bashkive, në cilësinë e tyre si kandidatë për kryetar bashkie, si subjekte zgjedhor përfitues nga keqpërdorimi i faqeve zyrtare të institucionit në rrjetin social facebook, duhet të mbahet përgjegjës për shkelje të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

... 12. Ndërkohë, përsa i përket caktimit të masës së sanksionit, KAS-i çmon se duhet t’i japë peshën që i takon faktit se ende nuk ka perceptim të qartë ndër aktorët se përdorimi i adresës zyrtare të institucionit në facebook dhe rrjetet e tjera sociale për fushatë elektorale përbën keqpërdorim të burimeve publike.

...13. Subjekti zgjedhor, pala paditëse, pasi është njohur me vendimin e K.A.S, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi”.

9. Kolegji Zgjedhor pasi është njohur me përmbajtjen e vendimit nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS, si dhe pasi ka marrë në shqyrtim pretendimin e palës së paditur në lidhje me legjitimitimin e palës padise, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, ka dëgjuar palët në lidhje me këtë pretendim.

10. Pala paditëse, Bashkia Shijak, nëpërmjet përfaqësueses së saj, ka deklaruar se në rastin konkret, Bashkia Shijak është investuar për të paraqitur kundërshtimet ndaj vendimit nr. 441, datë 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe ndaj vendimit nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS-it, pasi këto vendime i janë njoftuar këtij institucioni në postën e tij elektronike. Nga ana tjetër, përfaqësuesja e Bashkisë Shijak, ka pohuar para Kolegjit Zgjedhor se ajo është paraqitur si përfaqësuese e Bashkisë Shijak, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga kryetari i kësaj bashkie, dhe jo në cilësinë e përfaqësueses së subjektit zgjedhor, kandidatit për kryetar të Bashkisë Shijak në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, pasi nuk është pajisur me prokurë të posaçme nga ky subjekt.

11. Nga ana tjetër, pala e paditur ka parashtruar para Kolegjit Zgjedhor mungesën e interesit dhe për rrjedhojë të legjitimitetit të palës paditëse Bashkia Shijak në rastin konkret, pasi sikurse rezulton në mënyrë të qartë nga përmbajtja e vendimit nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS, ky i fundit ka vendosur sanksion administrativ ndaj subjektit zgjedhor, kandidatit për kryetar të Bashkisë Shijak, Z. Elton Arbana dhe jo ndaj Bashkisë Shijak. Në këto kushte, sipas kësaj palë, pala paditëse Bashkia Shijak, nuk ka interes të ligjshëm për paraqitjen e padisë.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR.

12. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi u njoh me përmbajtjen e kërkesëpadisë dhe akteve bashkëlidhur asaj, dëgjoi qëndrimet e palëve ndërgjyqëse në lidhje me legjitimitimin e palës paditëse, si dhe analizoi dispozitat ligjore të zbatueshme, vlerëson se padia e paraqitur nga Bashkia Shijak, është një padi që nuk mund të ngrihet dhe për rrjedhojë duhet të vendoset pushimi i gjykimit.

13. Sikurse rezultoi nga përmbajtja e kërkesëpadisë, mbi bazën e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për caktimin e sanksioneve administrative, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, me vendimin nr. 84 datë 08.05.2023 ndër të tjera ka vendosur: *1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. 2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, bazuar në nenin 172, pikën 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, në cilësinë e subjektit zgjedhor ndaj: - z. Elton Arbana, kryetar në bashkinë Shijak”.*

14. Më tej, në pjesën arsyetuese të vendimit të mësipërm, KAS-i ka arsyetuar në mënyrë të qartë se sanksioni administrativ ndaj z. Elton Arbana, i është vendosur këtij të fundit në cilësinë e subjektit zgjedhor, si kandidat për kryetar të Bashkisë Shijak. Në lidhje me këtë konkluzion, KAS, ka referuar edhe në përmbajtjen nenit 2 pika 20 të K.Zgjedhor, i cili përcakton se: *“subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, KAS-i ka konkluduar se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetshtëm, si dhe për shkak se postimet e aksesueshme në rrjetin social “Facebook” bëjnë fjalë për veprimtari elektorale të tyre dhe jo të subjektit që e mbështet, atëherë për këto shkelje duhen trajtuar subjekt zgjedhor përfitues, kandidatët dhe jo partia politike që i mbështet ato.

15. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson të marrë në analizë legjitimitetin e palës paditëse Bashkia Shijak në paraqitjen e padisë objekt gjykimi. Në lidhje me këtë element, Kolegji vlerëson se në zbatim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, çdo person i interesuar ka të drejtë të ngrejë padi për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e parashikuara në ligj. **Padia është mjeti procedural për të mbrojtur te drejtat e pretenduara të cënuara. E drejta për paraqitjen e padisë në aspektim procedural formal** dallon nga e drejta apo interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material (te se drejtes subjektive të cënuar) dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. **Në këtë vështrim juridik nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur përmes saj nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër.**

16. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë në Nr.270/2014 të Kolegjit Civil në të cilin ka arsyetuar se: *“Padia, si një mjet procedural mbrojtjeje i të drejtave subjektive dhe i marrëdhënieve juridike-civile, është një institut i së drejtës procedurale civile, që gjen rregullim në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (neni 32). Në vështrim të nenit 468 të Kodit të Procedurës Civile padia nuk mund të ngrihet në rastet e mungesës të parakushteve procedurale, mungesës së zotësisë së palëve (nenet 33 dhe 91 të K.Pr.Civile); apo në raste të tilla si mungesa e legjitimitetit formal dhe interesit për të ngritur padi, (neni 184 i K.Pr.Civile), si dhe kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar në një normë të së drejtës”*.

17. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji Zgjedhor, vlerëson se pala paditëse Bashkia Shijak, nuk legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi nuk ka interes të ligjshëm për paraqitjen e saj. Kjo pasi, vendimi i KAS-it objekt kundërshtimi pranë Kolegjit Zgjedhor, nuk pretendohet se ka cënuar një interes të ligjshëm të Bashkisë Shijak, sakohë që nuk rezulton që nëpërmjet këtij vendimi të jetë vendosur një sanksion administrativ ndaj këtij insitucioni. Sikurse rezulton e qartë nga përmbajtja e vendimit, KAS-i ka vendosur një sanksion administrativ ndaj subjektit zgjedhor “Kandidat për kryetar të Bashkisë Shijak, z. Elton Arbana”. Fakti që ky i fundit rezulton të jetë edhe aktualisht kryetar i Bashkisë Shijak, mbi bazën e mandatit të fituar si

rezultat i zgjedhjeve të mëparshme për organet e qeverisjes vendore, nuk përbën shkak ligjor për të legjitimuar Bashkinë Shijak si palë paditëse në këtë proces gjyqësor. Sanksioni administrativ objekt ankimi, është aplikuar për shkaqe që nuk lidhen me ushtrimin e funksionit të z. Elton Arbana si Kryetar Bashkie. Në rastin konkret, z. Elton Arbana është dënuar administrativisht për shkak të veprimtarisë së tij si kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, në cilësinë e tij si subjekt zgjedhor në kuptim të nenit 2 pika 20 e Kodit Zgjedhor, cilësi të cilën e gëzon në mënyrë të pavarur nga funksioni i tij si Kryetar i Bashkisë Shijak. Ky i fundit legjitimohet personalisht të kundërshtojë vendimin Nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS, por nuk gëzon të njëjtin legjitimitet personi juridik publik, Bashkia Shijak, në të cilën z. Elton Arbana ushtron detyrën e Kryetarit të Bashkisë.

18. Në nenin 145 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: *“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në kolegjin zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të K.Q.Z-së kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshme brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor”.*

19. Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se pala paditëse Bashkia Shijak, nuk plotëson kushtet ligjore për t’u legjitimuar në paraqitjen e padisë objekt gjykimi, pasi nuk rezulton që të ketë statusin e subjektit zgjedhor, si dhe nuk provon interesin e ligjshëm në rastin objekt gjykimi.

20. Në arritjen e përfundimit të mësipërm, Kolegji Zgjedhor mban në konsideratë edhe praktikën e këtij Kolegji, i cili në vendimin Nr. 16, datë 24.04.2023 ka mbajtur qëndrimin se: *“Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se, nepermjet kësaj praktike, rezulton të jenë marrë në analizë (edhe pse jo në rend kronologjik), legjitimimi formal dhe ai substancial/material, duke vendosur standardin sipas te cilit:*

- *subjekti ankues legjitimohet formalisht, vetem kur konfirmohet te kete qene pikerisht ai, iniciuesi i procedures administrative;*
- *subjekti ankues legjitimohet substancialisht/materialisht vetem nese ai, si subjekt qe ka vene ne levizje proceduren administrative, provon se nepermjet vendimarrjes respektive, i jane cenuar interesat ne baze te Nenit 145 te Kodit Zgjedhor”.*

21. Në rastin konkret nuk rezulton që pala paditëse Bashkia Shijak të ketë qënë subjekti që ka iniciuar procedurën administrative, në përfundim të së cilës është dhënë vendimi Nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS. Gjithashtu, në rastin konkret nuk rezulton që KAS-i në vendimin objekt kundërshtimi, të ketë disponuar në lidhje me cënimin e interesave të ligjshme të palës paditëse Bashkia Shijak.

22. Në sintezë të analizës së mësipërme, Kolegji Zgjedhor vlerëson se në çështje objekt gjykimi konstatohet në mënyrë të qartë mungesa e legjitimitetit procedural dhe interesit për të ngritur padi të palës paditëse Bashkia Shijak. Kolegji vlerëson se në mungesë të elementëve të mësipërm, të cilët përbëjnë elementë proceduriale thelbësore për të investuar gjykatën, padia objekt gjykimi vlerësohet si një padi që nuk mund të ngrihet dhe si e tillë, nuk mund të merret në shqyrtim në themel nga ky kolegji.

23. Në konkluzion të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se në rastin konkret do të gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, sipas parashikimit të nenit 155/1 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet shprehimisht se: *“1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesëpadive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji Zgjedhor zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e pare”*.

24. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor, për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi referon në nenin 299 pika “d” e K.Pr.Civile në të cilin parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:...c)...padi nuk mund të ngrihet, ose gjykimi nuk mund të vazhdojë...”*. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, Kolegji Zgjedhor vlerëson se gjykimi i kësaj padie duhet të pushohet si një padi që nuk mund të ngrihet, për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës paditëse.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 pg.1 (a) të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 299 (d) të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më datë 15.05.2023.

GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTARE
Emona Muçi (pjesërisht kundër)	Alma Kolgjoka	Manjola Xhaxho	Edlira Petri (kundër)	Marsela Dervishi